

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI



QENDRA
E PROVIMEVE



KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES SË NXËNËSVE NË FUND TË CIKLIT TË TRETË TË SHKOLLËS FILLORE

UDHËZIM

KOHA PËR ZGJIDHJEN E TESTIT ËSHTË 70 MINUTA.

Mos e hap testin dhe mos fillo t'i zgjidhësh detyrat para se të japë leje mësimdhënësi kujdestar.

Testi **DUHET** të jetë i shkruar me laps kimik ose me stilolaps.

Shkruaj lexueshëm dhe me shkronja dore.

Nëse shkruan me shkronja shtypi, thekso shkronjën e madhe atje ku duhet të jetë. Respekto rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore. Nëse mendon se ke gabuar në zgjidhjen e detyrës, vendos një vijë të kryqëzuar (X) mbi të dhe zgjidhe përsëri.

Nuk guxon ta përdorësh korrektorin.

Detyrat nuk e ke për detyrë t'i zgjidhësh me rend ashtu siç janë dhënë në test. Nëse e përfundon punën më parë, kontrolloji edhe një herë zgjidhjet tua.

Detyra do të vlerësohet me zero pikë nëse:

- ▶ është e pasaktë
- ▶ është e palexueshme dhe nuk është e qartë
- ▶ është e shkruar me laps grafit/të thjeshtë
- ▶ është shkruar ose rrethuar edhe përgjigjja e saktë dhe e pasaktë

ME FAT!

SHIFRA E NXËNËSIT

QERSHOR, VITIT MËSIMOR 2023-2024

FAQJA E ZBRAZËT

ARKITEKTURA

Arkitektura është arti i projektimit të ndërtesave dhe strukturave të tjera. Ajo duhet të sigurojë që ndërtesat të jenë të forta, të duken bukur dhe t'i përshtaten qëllimit të tyre.

FILLIMET E ARKITEKTURËS

Ndërtesat e para ishin të thjeshta. Qytetërimet e lashta të Mesopotamisë (Iraku i sotëm) ndërtonin shtëpi të thjeshta nga tulla balte të thara në diell. Ndërsa punëtorët bëheshin më të aftë, ndërtesat e tyre u bënë më komplekse. Egjiptianët e lashtë ndërtuan piramida të mëdha si varre për mbretërit e tyre të vdekur.

ARKITEKTURA GREKE DHE ROMAKE

Arkitektura perëndimore siç e njohim sot filloi të merrte formë në Greqi. Arkitektët grekë zhvilluan një stil klasik të dominuar nga kolona të bukura prej guri dhe mermeri. Ndër shembujt e ruajtur të arkitekturës greke janë tempujt, si Pantheonin në Athinë dhe teatrot në ambiente të hapura.

Romakët kopjuan stilin arkitekturor grek, por në të njëjtën kohë shpikën teknikat e tyre të ndërtimit, si harku i rumbullakosur dhe kupola. Harku mund të mbajë shumë peshë, gjë që i lejon arkitektit të projektojë ndërtesa më të mëdha dhe më të forta. Arkitektët romakë ndërtuan: banja publike, pallate, ura dhe arena të mëdha sportive.

NDRYSHIMET E STILIT

Gjatë mesjetës, arkitektët evropianë zhvilluan mënyra të reja ndërtimi me ndihmën e gurit. Lulëzonte stili gotik. Shumë katedrale evropiane janë në këtë stil. Ato dominohen nga harqe të këndshme me majë, tavane të larta dhe dritare xhami të ngjyrosura.

Renesanca, e cila filloi në Itali, nxiti një valë të re të zhvillimit arkitektonik. Domethënë, arkitektët shpenzojnë më shumë kohë duke projektuar shtëpi private dhe ndërtesa publike. Që nga shekulli i 16-të, arkitektët kanë qenë shumë të kërkuar.

ARKITEKTURA BASHKËKOHORE

Tulla dhe guri edhe në kohët moderne kanë mbetur materialet kryesore të ndërtimit, por janë shfaqur edhe materiale të reja sikur: betoni, çeliku, qelqi dhe plastika. Shpikjet e reja si ngrohja qendrore, ndriçimi elektrik dhe ajri i kondicionuar kontribuan gjithashtu në revolucionin në arkitekturë. Në vitin 1854, u shpik ashensori, i cili u mundësoi arkitektëve të projektonin ndërtesa shumëkatëshe. Rrokaqiejt e parë me një skelet çeliku u ndërtuan në Çikago dhe Nju Jork në fund të shekullit të 19-të.

Arkitektët sot punojnë së bashku me inxhinierë dhe gjeodetë. Kompjuterët përdoren për të llogaritur peshat dhe forcat e ndryshme në ndërtesën e planifikuar dhe për të ndryshuar dizajnin nëse është e nevojshme. Disa ndërtesa moderne kanë një formë dramatike ose futuriste, e cila nuk do të ishte e mundur pa ndihmën e teknologjisë më të fundit.

(përgatitur sipas tekstit të Katarina Strugar VIII3, botuar në revistën Shkëlqimi, nxënëse e shkollës fillore „Dr. Dragisha Ivanoviq“, Podgoricë, numri 2, maj 2011)

1. Cili është qëllimi i arkitekturës?

1 pikë

2. Stilin gotik e karakterizojnë:

1. Harqet me majë dhe tavanet e larta
2. Piramidat nga guri dhe mermeri
3. Kupola dhe harku i rumbullakosur i cili bart peshën e madhe

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

1 pikë

3. Përse ka qenë me rëndësi për arkitektët shpikja e ashensorit?

1 pikë

4. Shkruaj të dhënat nga teksti me të cilat do të dëshmosh se teknologjia moderne u ndihmon arkitektëve.

1 pikë

5. Nëse pohimi është i saktë rretho S, ndërsa nëse është i pasaktë rretho P.

POHIMI	SAKTË	PASAKTË
Betoni dhe çeliku janë material i ri ndërtimor.	S	P
Egjiptianët e lashtë dhe qytetërimet e lashta të Mesopotamisë ndërtonin shtëpi të thjeshta nga tulla balte.	S	P
Arkitektët romakë e kanë ndërtuar Pantheonin.	S	P

1 pikë

Lexo fragmentin nga romani "Rruga e shtëpisë sime" dhe përgjigju në pyetjet 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11.

...

Plaka mbylli sytë vetëm mbasi tha „Kthehu! „Me këtë fjalë në gojë ajo shkoi... Shkoi ajo, po na tha atë që na lëndoi plagën aq te ithët, na hapi plagë të reja që kurrë s'do të na shërohen...”, thoshin njerëzit dhe sa rëndë u vinte ajo fjalë e saj. Ky amanet i fundit i gjyshes që do të mbahej mend gjithmonë në jetë dhe do të na i lëndonte përherë plagët e shpirtit na vinte më rëndë se çdo gjë tjetër që na kishte ndrydhur në jetën tonë të plagosur.

Këtu zinin fill sonte mendimet tona më të rënda se errësira e natës. Mandej qëndronim ashtu dhe kujtonim disa çaste fjalët e saj që i thoshte gjithnjë sa herë që binte biseda dhe thuajse të cilat po i nxirrte me rrënjë nga kraharori i saj i vyshkur e i thatë:

„Le të mbetet vorri im këtu, le të humb unë përgjithmonë, por mos i raftë kujt tjetër të hyjë këtu në dhe! Unë le të mbetem te djali im... .E njerëzit le të tregojnë me gisht vorrin tim si të fundit. Ose si në përralla le të tregojnë për një vorr plake këtu...!

...

Dhe, një ditë do të mbeteshin mbas nesh vetëm varret dhe rrëfimet për to. Njerëzit tash nuk do të rrëfenin më për ne që erdhëm dikah në këtë katund dhe katundi nuk na deshti e vdiqëm një nga një, ashtu në heshtje e shpejt, sepse nuk mundëm të ngulim aty, por do të tregonin për varret që mbeten aty. Erdhëm të vemë themelet, të ngrisim pullaze, e hapëm varre! ...Erdhëm të jetojmë dhe e gjetëm vdekjen... .

6. Në çfarë mbështetet rrëfimi dhe për çfarë flitet në këtë fragment?

2 pikë

7. Teksti i mësipërm është shkruar në stilin funksional:

1. shkencor
2. publicistik
3. letrar-artistik

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

1 pikë

8.

Cili ishte amaneti që la plaka për pasardhësit e saj dhe me të cilën shprehje mund ta zëvendësojmë fjalën "amanet"?

2 pikë

9.

Rretho numrin para fjalisë së përbërë me bashkërenditje:

Le të mbetet vorri im këtu, le të humb unë përgjithmonë, por mos i raftë kujt tjetër të hyjë këtu në dhe!"

1. shtuese
2. veçuese
3. përmbyllëse
4. kundërshtore

1 pikë

10.

Emërto figurat stilistike të përdorura më poshtë.

Erdhëm të jetojmë dhe e gjetëm vdekjen _____

Kraharori i saj i vyshkur e i thatë _____

2 pikë

11.

Në bazë të fragmentit trego se në cilën vetë rrëfen personazhi kryesor i veprës:

1. Në vetën e parë
2. Në vetën e dytë
3. Në vetën e tretë

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

1 pikë

12.

Në vijë pas fjalëve shkruaj, cila është fonema që e kanë të gjitha këto fjalë.

uthull _____

fillon _____

llamba _____

1 pikë

13. Plotëso tabelën ashtu si e kemi filluar.

PERSONAZHI	VEPRA	AUTORI
Teli	<i>Vilhelm Teli</i>	Fridrih Shiler
Nita		
Roberti		

2 pikë

14. Nëse themi se dikush U BË GAZI I BOTËS, ai është:

1. gaztor i pashoq
2. hokatar i madh
3. beja e dheut

Rretho shkronjën para përgjigjes së saktë.

1 pikë

15. Rretho numrin para fjalisë e cila është shkruar sipas rregullave të drejtshkrimit.

1. S'foli për njëme me mua tërë natën, nuk e di përse.
2. Në detyrën e më të mirë që e kam ba spat parregullsi.
3. Frutat që i morëm nuk ishin kenë me shije si më parë.
4. Të gjithë më kërkuan derisa nuk më gjetën se ku isha fshehur.

1 pikë

16. Nga cila fjalë mund të kuptohet kryefjala që mungon në fjalinë: "Pastaj, shkoi e hyri përsëri në shtëpi"?

Kryefjala kuptohet nga fjala: _____

1 pikë

17. A) Cakto rasën e emrit të nënvizuar në fjalinë e mëposhtme.

Fisniku tundi kokën në shenjë mohimi.

1 pikë

B) Sqaro përse është përdorur presja në fjalinë: Skënderbeu mishëronte vetitë më pozitive të popullit: urtësinë, mençurinë e trimërinë.

1 pikë

18. Shkruaje me shkronja numrin 560.

1 pikë

19. A) Nga fjalët hekur dhe punues formo fjalën e përbërë.

1 pikë

B) Rretho numrin para fjalës së shkruar gabim.

1. arrifsha
2. marrça
3. ndenjsha
4. gjetsha

1 pikë

Lined writing area with horizontal lines.

Lined writing area with horizontal lines.

Lined writing area with horizontal lines.



E PLOTËSON KOMISIONI PËR VLERËSIM

Numri i përgjithshëm i pikëve të fituara në test:

Nota: _____

KOMISIONI:

VLERËSUESI KRYESOR:

Data _____ 20_____